

## “... SCHËPUD’AR ...”

Sokrat **HANAJ**

### PËRMBLEDHJE

“Që të gjitha degët e një peme rrjedhin nga i njëjti trung dhe...ndryshimet që ato i shfaqin njëra tjetrës janë kur i largohen trungut dhe jo kur i afrohen atij. Gjetja e origjinës së përbashkët, sigurisht kërkon ndërtimin e një mentaliteti të përbashkët, të një trupi të vetëm të quajtur qytetërim i përbashkët. “Shqipëria ruan në vetvete një potencial të jashtëzakonshëm”, sipas Shpresa (Musai) Omer, kurse sipas Maksim Zotos: “Gjuha e tyre (shqipja) është gjuha e Zotit! Nostradamus predikonte: <Shqiptarët...përsëri do ta habisin botën.” Potencialet që i duhen sot Botës janë energjitë intelektuale, të akumuluar në formën e një gjuhe hyjnore, material i gatshëm për të shpëtuar Botën nga provokimet e një realiteti që zgjon aftësitë tona nëpërmjet përplasjes së gjunjëve mbi kalldrëmet e historisë. Fillimet e hyjnore vijnë nga thellësitë e shekujve në formën e adhurimit të natyrës, e zërit të saj ZEUS i vetëtimës e bubullimës dhe fëshfëritjes delikate të gjetheve të LISIT, vazhdon me qytetërime të Lisit (LEZHËS), të Bylisit (BYLLIS-DY YLLËSI) deri tek misteri MONA LISA. “Fjalët <<HYJN>> dhe <<HYJNORE>> në shqipen e sotme, ... origjinën e kanë nga fjala <<HYLL>> - Kastriot Myftari. Vet popullsia “HYJNORE, <<YLLËT>> janë ilirë dhe kanë banuar afër bylynëve...” – Elena Kocaqi. Toka e tyre, atdheu i tyre, është Alb-anija, ajo që mban AL (AL-banët, AR-bërësit, shke-ncëtarë të AL-kimisë), janë ata që çlirojnë arin nga plumbi, ata që shkëpusin AR (SCHËPUD’AR), është anija me të mbijetuarit pas përmbytjes së një epoke të artë. “Tekstet më të lashta të njerëzimit na flasin për një epokë të artë... janë <<PELLAZGËT>>, banorë të Atlantidës, të mbijetu-ar fundosjes” (Armir Tirana) Gjithçka sa u tha më sipër, përfshi edhe këtë përmbledhje, ka vetëm një qëllim, sikurse : “Frensis Bejken... në veprën: <<ATLANTIDA E RE>>... na përshkruan një UTOPI... për të arritur shtetin IDEAL në botën politike” ( Jim Marrs tek : “Kush e sundon Botën”).

**Fjalë kyçe** – gjuha e folur, gjuha e Zotit, qytetërim i përbashkët,

### HYRJE

Përpara se unë të shkruaj për lëndën e parë të këtij materiali, pra për idetë, tezat apo mendimet në funksion të qëllimit të këtij shkrimi, po nënvizoj se zgjidhja tek-nike e mënyrës së të shkruarit është paksa e veçantë, por sipas meje, e domosdoshme. Në të mbizotëron një dozë e madhe referencash dhe materialesh në thonjza, të cilat krahasuar me punën krijuese, i ngjajnë më shumë një “fotomontazhi” që krijojnë një pamje të “pikturuar”, me penelatat e një artisti që edhe pse impresionues për nga mënyra e realizimit mbetet një impresion, një përshtypje. Kjo do të thotë që dëshira ime në këtë shkrim është që t’ju çojë sa më afër asaj që kam ndjerë unë nëpërmjet studimit tim, dhe jo nëpërmjet mendimit tim. Unë do të doja të “fotografoja” këtë realitet të botës së shkrimit dhe jo ta pikturoja duke pasur si qëllim që nëpërmjet këtij shkrimi ju të shihni atë që shoh unë dhe jo atë që mendoj unë.

Ajo që është më e rëndësishme për qëllimin të cilit po i përkushtohemi, në kërkimin e origjinës sonë, është se gjithë sa njoftohet në këtë shkrim nuk duhet nënkuptuar me karakter nacionalist, as racor, politik apo fetar. Nëqoftëse ne kërkojmë origjinën tonë ajo u intereson të gjithëve, qofshin të bardhë apo me ngjyrë, ajo i përket çdo kombi dhe feje. Që të gjitha degët e një peme rrjedhin nga i njëjti trung, dhe ... ndryshimet që ato i shfaqin njëra tjetrës, janë kur i largohen trungut, dhe jo kur i afrohen. Prishja e ekuilibrave vjen nga preferencat, nga dëshirat dhe praktikatat për dallime dhe privilegje, nga përpjekjet përjashtuese dhe jo tolerante, nga ar-miqësitë reciproke që vijnë prej zgjidhjeve të dhunshme dhe jo dashurisë reciproke. Gjetja e një origjine të përbashkët, sigurisht kërkon ndërtimin e një mentaliteti të përbashkët, të një trupi të vetëm të quajtur qytetërim i përbashkët, si pjesë e të njëjtit trung.

### 1. "... SCHËPUD'AR ..."

Mrekullia e krijimit, në shkallën më të lartë, pa dyshim është *gjuha e folur*, me cilësinë e mendimit që vetë qenia flet. Sipas Naim Frashërit: "Gjuha jonë sa e mirë, sa e ëmbël, sa ...e vlerë...", tregon për *VLERAT* shprehëse në mendim, të vetë gjuhës shqipe. "...Gjuha e tyre (shqi-pja), sipas Maksim Zotos, është *gjuha e Zotit!* Kishte të drejtë Nostradamus, kur predikonte: << Shqiptarët ende nuk i kanë luajtur të gjitha kartat e tyre dhe se padyshim ata PËRSËRI do ta habisin botën në arenën ndërkombëtare >>." (Standart" 29.11.2010 f.16.)

Kjo është befasuese dyfish sepse në rast se shqiptarët habisin botën ky do të ishte, sipas Nostradamusit, rast i përsëritur. Kjo na shtron detyrën të zgjohemi nga gjumi dhe të kërkojmë rastin e mëparshëm nëse egziston një i tillë dhe më shumë se kujtdo kjo i takon të jetë detyrë e vetë shqiptarëve pse jo edhe e qëndrës kërkimore dhe studimeve pellazgjike. Dhe nuk janë të paktë ata shqiptarë, por edhe të huaj që po rrëmojnë në këtë fushë, është një armatë e tërë. Referencat ku unë drejtohem kanë të bëjnë vetëm me këndvështrimin tim, ashtu siç 2. Shpresa (Musai) Omer thekson bindjen e saj si më poshtë:

*"Shqipëria ruan në vetvete një potencial të jashtëzakonshëm. Jepini këtij populli vendin që i takon në histori si dhe mundësinë të shpalosë potencialet e tij dhe do të përjetoni kohën me energji, me paqësore dhe më pozitive, kohët më të bukura që ka përjetuar ndonjëherë kontinenti ynë, për këtë jam e bindur!"* ("Në gjurmët e pellazgjishtes" f. 9)

Atëherë, kjo gjuhë e folur *shqip* "gjuha e Zotit"-- sipas Maksim Zotos, çkërkon t'i thotë njerëzimit?! Gjithashtu Eva Brinja në një shkrim të saj në gazetën "Ndryshe", më 29.5.2009 f.13, ja se si e citon Fabian Barkatën, një prej dijetarëve të mëdhenj të huaj, kur ai shprehet për popullsinë e Lisit, sot Lezhës: "*Popullsi e paprishur...Këtu do të vijnë një ditë dhe do të ulen dijetarët e filozofët e botës për të nxënë dhe për të thënë*". Po ashtu kemi: "LISI...fshat në rrethin e Matit..." (F.E.SH. f.628) "LIS-Patrosi fshat në rrethin e Durrësit" (po aty) "BYLISI, qytet ilir pranë fshatit Hekal të Mallakastrës." (f.137) Po ashtu LISI ishte druri i shenjtë për priftërinjtë dodonas të Zeusit sipas "Prometeu i lidhur" i Eskilit, bot. i IV. f.78, apo tek "Dodona Pellazgjike" nga Xhevair Lleshi në "Standard". Dhe më tej "Zeusi -- sipas Homerit... është dodonas dhe pe-llazg, Zot i plotfuqishëm i bubullimave dhe vetëtimave, që i jepte përgjigjet nëpërmjet fësh-fërimës së gjetheve të lisit, shpjegohet me fjalën shqipe zë-zëri". (Sh. Musai "Në gjurmët e pellazgjishtes" f.18). "Edhe tek baltët (pranë detit baltik) druri i lisit ka qënë i shenjtë. Në dodonë profetësia tregohet nga fëshfëritjet e gjetheve të lisit. Ashu si dhe tek baltët... në dodonë tre gjethet e lisit, simbolizonin të shkuarën,

të tashmen, dhe të ardhmen" (E.Kocaqi "Roli pellazgo- ilir në formimin e kombeve dhe gjuhëve europiane" f.75) Shpresa Musai "Në gjurmët e pellazgjishtes" f.108: "EICHE-LIS, shqip AJKË. Për pellazgët lisi ishte dru i shenjtë, "AJKA e DRURËVE". "Prej lisit, drurit të lisit, rrjedh një filozofi hyjno-re si feja Druidë." (E.Kocaqi "Roli pellazgo-ilir..." f.20). Dhe për ta mbyllur, kryevepra e kijimtarisë njerëzore dhe misteri i psikologjisë njerë-zore është portreti i Leonardo da Vinçit, emri "Mona L'ISA", si dhe kuptimi që i jep Dan Brown në "Kodi i Da Vinçit" f.150 ku "fjalë për fjalë" quhet: "lulja e LISIT". Në dijeninë time, ky por-tret ka sipërfaqe e kornizë (me gjethe) dru lisi, Mos vallë "lulja e LISIT" e Leonardo da Vinçit, gdhendja figurative në gurë, në teatrin e BYLISIT (lule e formuar me pesë gjethe LISI), gjithashtu fjalët BYLIS (BY-LIS) dhe Mona L'ISA kanë një mister të përbashkët, ashtu si fshati, qyteti dhe druri me emrin LIS?! Apo mos vallë kemi një qytetërim "YJOR" apo "HYJNOR", si më poshtë?: "Fjalët <<HYJN>> dhe <<HYJNORE>> në shqipen e sotme, qartësisht e kanë origjinën nga fjala <<HYLL>>. (K.Myftaraj "Sot" 5.11.2010). Ndërsa vet popullsia "HYJNORE", "YLLËT, janë Ilirë dhe kanë banuar afër Bylynëve..." (E.Kocaqi "Roli pellazgo-ilir..." f.28). Mos vallë YLLËT "banor pranë Bylynëve" arritën me kulturën e tyre të zhvillonin një qytetërim sipas kuptimit Bylis, ose BYLLIS (*dy ullësi*), ose *dy yjësi*, sistem me dy vatra drejtimi, tip DEMOKRACIE, POZITË-OPOZITË.

"... <<Lidhja e Bylynëve>> ... ishte një minishtet që ruante tiparet e një demokracie ushta-rake (ose "perfekte"), e cila kontrollohej nga qyteti i BYLISIT". (I.Gjika "Standard" 30.5.2011). Le të shohim një variant tjetër: BYLISI "qytet Ilir pranë fshatit HEKAL të Mallakas-trës" (F.E.SH. F.137) Sipas Jim Marrs: "... ARKA e NOES...mjet komunikimi me Zotin ... <<shtëpia e madhe>>...<<HEKAL>>." ("Kush e sundon botën" f.372) "Tradita të ndryshme të krishtera e përshkruanin Shën Marinë si një ARKË <<të gjallë>> të NOES." (po aty f.388) "Tempull, hebraisht HEYKAL, ndërtesë e madhe" (Fjalor biblik) "...Nuk është fjala për një tempull të vërtetë... por një tempull i ngritur në mëndjen tonë, me dhoma të fesë, filozofisë, shkencës..." (A.Shu-garts "Sekretet e djalit të vejushes" f. 58). Nga Dan Brown "Simboli i humbur": "Shkenca NOEtike: porta moderne drejt urtësisë antike" f.98 "NOEtike... - dije e brendëshme, intuitë" f.99 "koha është lum dhe librat janë barka" f.98. Pra: ARKA e NOES, në këtë kuptim është dija e brendëshme, vetëdija si barkë shpëtimi. Kjo vetëdije, NOETIKA, te Rafaele Morelli përcaktohet: "Detyra e alkimistit është të nxisë organizmin tonë të prodhojë sasinë më të madhe të mundshme të vetëdijes, ARI, duke bërë që plumbi (materia) të çlirojë sasinë më të madhe të mundshme të tij". ("Nuk kemi lindur për të vuajtur" f. 6). Këta çliroes të ARIT nga plumbi, këta shkëputës të ARIT, quhen SCHËPUD'AR (shkëput'AR) ose ARBËRËS (Arbër), AL-BAN(Albër). Koha e mbijetesës së tyre është lumi ndërsa dija e tyre është BARKA, ARKA (AR-KA), anija e AR-janëve, ALB-AN(IJA), ALB-ANIJA, që mundësoi mbijetesën e tyre. "...Ilirët qartësisht qenë AR-JANË..." (K. Myftaraj "Sot" 5.11.2010). "Blavatskaja pretendonte të disa rrënjë të njerzimit, ku rrënjët ARJANE...kishin prejardhje nga ATLANTIS..." (Sh.B.Lawrence "Sekretet e numerologjisë" f. 23). "ARKË (DIE ARCHE NOAH)- arkë (ar-ka), (arka e Noas) pjesët përbërëse të saj : AR+KA, me kuptimin "ajo që ka ar", ose "ajo që mban arin". (Sh.Musai "Në gjurmët e pellazgjishtes" f.64) Pra duke shtuar NOUS ("Simboli i humbur") – dije e brendshme intuitive, do të kemi se arka e Noes është "ajo që mban arin e njohjes, INTUITA".

Ndërsa tek Aristidh Kola, "Gjuha e Perëndive" f. 243 kemi: "Harmonia përbën parimin kryesor të qytetërimit grek. Harmonia ka pikërisht, bashkimin e dy ose më shumë gjërave për krijimin e një të trete, që të jetë më e bukur dhe më e pranueshme. Fjala armonia del nga rrë-nja AR që tregon

ARNO, arnë, bashkoj dy gjëra të ndryshmedhe f. 71: "Në kohën e lulëzimit të demokracisë në Athinë do të dëgjojmë nga goja e Eskilit të madh shprehjen: -ZEUSI, cilido qoftë është forcë që HARMONIZOHET me llogjikën dhe vepron me drejtësi ... përbën atë që kërkohet dhe është e dëshirueshme për regjimin e ri..." dhe f.183: "AR, ka kuptimin thumbi, maja e shigjetës, ...maja e një sendi" pra është PJESA KULMORE, jo vetëm e një sendi por edhe e mënyrës së jetesës.

D.Brown "Simboli humbur": "Qëniet njerëzore gjenden në pragun e një epoke të re, kur do të fillojnë të kthejnë sytë te... mënyrat e vjetra...Legjenda që nuk shuhet për shekuj të tërë e ka një arsye që mbijeton" f.83 "Misteret antike janë urtësia e humbur e të gjitha epokave" f.105 "Misteret antike kanë të bëjnë me një numër dijesh të fshehta...që të jep aftësi të fuqishme, që gjenden të fjetura në mendjet e njerëzve". f.106

Pra si pas referencave të fundit, pragu i një epoke të re është porta e mistereve antike, për një mënyrë kulmore, TË ARTË, në jetesën e njerëzve, bashkëjetese e "DY GJËRAVE TË NDRY SHME"-DEMOKRACI e KULLUAR.

Njuton: "Nëse kam parë larg, kjo ngaqë kam qëndruar mbi supet e GJIGANTËVE". ("E Panjohura" 823 f. 2) Kush ishin pra këta gjigantë e CIKLLOPË, dhe Njuton shprehet për një lloj të vetëm apo ata të tijët ishin ndryshe?! Sidoqoftë bëhet fjalë për "ATA QË SHOHIN LARG". "Këta Gigantë (gjigantë) ishin GIGAS grekë dhe GEGË (shqip), emri i të cilëve është ruajtur deri në ditët tona e që e mbajnë shqiptarët e veriut, GEGË." (E.Shnajder "Pellazgët dhe pasardhësit e tyre" f.49) ...ose..."Në të njëjtën kohë toka lindi CIKLLOPËT, ME NJË SY NË BALLË..." (po aty f.61) "Pellazgët janë quajtur nga helenët PELASGOI, PELAGOI, PREJ së LARGU (PELARGOI = PELARGJ)" (po aty f.38) "...Strabon-Myler,... e nxjerrin prejardhjen e <<PELLAZGUT>> nga <<PELARGU>> (A.Kola "Arvanitët dhe prejardhja e grekëve" f.38) Tek:

"Pellazgët e pasardhësit e tyre" nga Eduard Shnajder, f.61 kemi: "Herodoti thotë: -disa njerëz me një sy të vetëm të madh, (minatorët) që quhen ARIMASPE (AR-ME-SHPËJ = arin e mbajnë në shtëpi) CIKLLOPËT, duhet të jenë mbledhës dhe mbajtës të arit". Siç e shihni emri i tyre është shumë shqip. Gjithashtu, po aty kemi: "Marsi, që grekët e quajnë ARes, është zoti që përfaqëson idenë e thellë, nderin". f.71. Po aty "...Feticizmi pellazgjik ishte krejtësisht vetjak, e se perënditë e emërtuara kishin *kuptimin e një ideje*, një fenomen e force të natyrës dhe asgjë tjetër." F.44. Edhe fjala HYJ (HYJ-NOR) lidhet me aftësinë për të hyrë në fenomene të natyrës, ndërsa fjala AR sipas Shirley B. Lawrence, tek "Sekretet e numerologjisë", është A+R do të tho-të: A-ja është fryma e ZOTIT, (f.92) është "spiritus" (SHPIRTI, f. 94) kurse germa R merret me shpalosjen shpirtërore të njeriut deri tek "SYRI I TRETË", *ndriçimi shpirtëror*, ku e gjithë dija është e kapshme për njeriun". (f.164) Syri i tretë, ose syri në "BALL" i dritës së cikllorit, është NDRIÇIMI SHPIRTËROR. Ai na çon tek "DRITA" apo "LULJA e DJELLIT" e ndërtuar me gdhëndje në shtyllën kryesore të teatrit të qytetërimit BYLIS, qytetërim i zhvendosur, sipas Neritan Cekës, në BALLIS, sot Ballsh. Pra BALLIS (I BALLIT) do të thotë "ndriçimi shpirtëror", "me yll në ball", (BYLLIS-BALLIS-BALLSHI). Pra AR DO TË THOTË KULMI, PIKA MË E LARTË E TË JETUARIT DHE E TË MENDUARIT.

Tek Eduard Shnajder "Pellazgët dhe pasardhësit e tyre" f. 35 kemi: <<SHQIPJA (SHQIPO- NJA) në Shqipëri quhet SHKYBE (SHKY-SHQYEJ) >> po ashtu bijtë e shqipes SCHËPUD'AR (sipas Agron Lukës), kurse "Gjuha e tyre (SHQIPJA)-sipas Maksim Zotos- ... gjuha e Zotit", kanë: SHKY (SHQYEJ) dhe SKËPUD (SHKËPUT) si rrënjë të përbashkët. Pra janë, siç thamë më lartë,

shkëputës të arit, ndriçimit shpirtëror, dritës së zotit të tyre të vetëtimave, ZEUSIT. "Shqiponja ka qënë për një kohë të gjatë një simbol fuqie, qëndrese dhe FLUTURIMI DREJTË QIELLIT. Ajo simbolizon edhe DIELLIN (DHE ZOTIN DIELL) DHE MADHËSHTINË SHPIRTËRORE... PËR DRUIDËT AJO ISHTE NJË SIMBOL I ZOTIT TË TYRE SUPREM". ("Kodet magjike" f. 274)

Aristidh Kola tek "Gjuha e perëndive" f.70 përcakton: "ILIRËT DHE ZEUSI-DIELL" dhe f.49-50 "ZEUSI-DEUS...ATI I PERËNDIVE dhe i njerëzve...identifikohet me dijen më të lartë, me atë që më vonë filozofët do ta quajnë <<MENDJA>> ose <<ARSYEJA>>, IDENTIFIKOHEJ ME DIELLIN". Edhe Shqiptarët të quajtur ALBANEZË, ndoshta nga latinët, që tregonte AGIMIN E DITËS, LINDJEN E DIELLIT". (E. Shnajder "Pellazgët dhe pasardhësit e tyre" f.23)

Pra duke rikujtuar: "...Ilirët qartësisht qenë arjanë" (Kastriot Myftaraj) dhe "... rrënjët arjane ... kishin prejardhjen nga Atlantis..." (Shirley Lawrence), shtojmë: (Arjanët) "... e lashtë kishin qënë mbartës të një SHKENCE TË FSHEHTË, e cila e kishte pasur origjinën në EDEN/ /ATLANTIDË" (J. Marrs "Kush e sundon botën" f.210)

Përfundimisht, fjala ARJAN mund të rrjedh pse jo, prej kuptimit si punues të tokës arë, bujq, sigurisht mund të jetë prej kuptimit ar-bërës, *floririt industial* dhe e treta mjeshtra të vetëdijës, arsyes (AR-SY). Përse të mos themi se edhe shqiptarët ashtu si gjithë raca njerëzore kanë kaluar një epokë feminare (bujqësore), një epokë të rritur (industriale) DHE NJË EPOKË TË PJEKURISË (EPOKA E ARTË).

"Tekstet më të lashta të njerëzimit na flasin për një EPOKË TË ARTË ... janë <<Pella-zgët>> banorë të *Atlantidës*, të mbijetuarit e fundosjes së kontinentit të tyre dhe të ikur drejt Europës dhe Amerikës..." (A. Tirana"R.D" 1.7.2011). "Platoni thoshte: *Atlantidasit vijnë në Athinë duke kaluar nëpër kolonat e Herkulit, kështu që duhet kërkuar në oqeanin Atlantik*" (S. Hushi "Metropol" f.14-15). "Hipoteza mbi *Trekëndëshin e Bermudës*, nga hapësirat shumë dimensionale, Atlantida e deri tek UFO-T... që ndodhen në oqeanin Atlantik..." sipas "Tirana Observer" 5.4.2011 f.10-11 na ndihmojnë për një hipotezë të vendndodhjes së dikurshme të Atlantidës. Tek "RD" 4. 9. 2009 f.14 "Atlantida një sajim i Platonit?" kemi: "Atlantida nuk ishte thjeshtë një ishull. Ky ishte një kontinent i madh... ishte bota e vërtetë para përmbytjes së madhe, KOPËSHTI I EDENIT... një kujtim universal i një vendi madhështor, ku njerëzimi i her-shëm jetonte në paqe dhe lumturi!" Kurse "RD" 18.09.2009 f.14-15 në shkrimin: "Të lashtët ishin më të avancuar" thekson për ATLANTIDËN: "Besohet se Atlantida e ka çuar teknologjinë në faza shumë të përparuara, shumë përtej asaj që ekziston në planetin tonë... Në pjesën e mbuluar nga uji të atlantidës... një pjesë e tempujve mund të gjenden nën rërën e fundit të detit... në brigjet e Floridas".

"Frensis Bejken...në veprën <<ATLANTIDA E RE>> ...na përshkruan një utopi... funksionuar për mijra vjet me qëllimin për të arritur shtetin ideal në botën politike". (J. Marrs "Kush e sundon botën" f.210)

Për më tej: "Atlanti sipas Homerit, ishte ai që mbante mbi supe SHTYLLA TË GJATA të cilat ndanin qiellin nga Toka." (Eskili "Prometeu i lidhur" bot. IV-të f.76) "Atlanti fuqimadh mban mbi supe *polet qiellorë*" (po aty f.37). Çfarë polesh qiellorë ishin këto, pikërisht, mbi oqeanin Atlantik, bile më e çuditshme pranë vendndodhjes së menduar të atlantidasve, kemi pikërisht pranë TREKËNDËSHIT TË ZHUKJEVE MISTERIOZE TË BERMUDEVE, sipas Top Channel

13.12.2005 ora 23:13 "Polet magnetike të Tokës po ndryshojnë me shpejtësi (në ekran pamjet: drejt Kubës rrymat magnetike)". Pra "shtyllat e gjata që ndanin qiellin nga Toka" ose "polet qiellore" sipas Eskilit janë SHTYLLA QIELLORE të energjisë universale që nuk ndikojnë vetëm në fenomenet e natyrës por ndoshta edhe në jetën e njerëzve. Në gazetën "Standart" 10.01.2011 f.16-17 në: "Trekëndëshi i Bermudeve, është një portë për udhëtimin në kohë", kemi: "...Fizikani Albert Ajnshtajn në teorinë e tij të planit të njësuar, flet edhe për teletransportimin, i cili mund të vijë nga një tufë e dendur elektromagnetike, që sjell si pasojë çrregullime në të gjitha paisjet... Ky rajon transporton të gjitha objektet që bien pre e stuhisë elektromagnetike në një hapsirë ose në një kohë tjetër."

Kjo na shtynë të mendojmë për një portë kalimi për në botë paralele si të themi "PORTA E PARAJSËS". Nëqoftëse kërthiza do të mund të fliste ajo do të na thoshte neve: "Kush hyn në mua, del në botën e re dhe kush ndahet prej meje, e kërkon përjetësisht parajsën e humbur". Ç'do të thotë kjo?! N.q.s. zona e TREKËNDËSHIT TË BERMUDEVE, është zona e Atlantidës së përmbytur dhe njëkohësisht siç thamë më lartë, është kopshti i Edenit ("RD" 4.09.2009) KU NJERËZIMI JETONTE NË PAQE DHE LUMTURI, atëherë duhet të mbajmë qëndrim dhe të mendojmë se vërtetë kemi të bëjmë me KËRTHIZËN E BOTËS. Duke studiuar librat e mistereve, kam bindjen se krijohet një pasqyrë shumë e qartë për parajsën e humbur, GRAALIN E SHENJ-TË, PORTËN E LUMTURISË PËR TË ARDHMEN E NJERËZIMIT Në gazetën "Standart" 31.01.2011 f.15 kemi: "Toka së shpejti me një... DIELL TË DYTË... të paktën për një apo dy javë. Një prej yjeve më të ndritshëm të qiellit tonë do të bëhet supernova (do të shpërthejë)... Që do të thotë se në tokë do të kemi dritë diellore 24 orë... Kjo mund të ndodhë para fundit të vitit 2012... ky lajm lidhet me të ashtuquajturin APOKALIPS TË VITIT 2012" 21.12.2012, nuk është datë "MAGJIKE" apo datë e rëndësishme si nata e Vitit të Ri, por ka të bëjë me pozicionin e trupave qiellorë dhe *forcat magnetike universale*, si më poshtë: "Njerëzit e lashtë mendonin se Hëna ndikonte shumë mbi jetën e njerëzimit" (A.Ostreni "Hëna trupi qiellor më i afërt i tokës" f.45). "Është e çuditshme por fakt që edhe konfiguracionet e planetëve në datat (28.7.1914) e fillimit të Luftës së I-rë botërore, (1.9.1939) e fillimit të Luftës së II-të botërore, janë të njëjta me konfiguracionet që pritet të ndodhin gjatë eklipseve të d.t.28.7.1999 dhe 11.08.1999" ("E Panjohura" 354 f.4). "Dëshmitarët e Jehovait" tek: "Jeta si erdhi ajo këtu..." f.228 shkruajnë: "1914, një pikë kthese në histori". Atëhere, eklipsi i vitit 1999, që daton me *fillimin e Rendit të Ri Botëror*, eklipsi i bujshëm i Nostradamusit, ka një bosht energjie Diell-Hënë-Tokë që unë po e quaj NJË SHTYLLË QIELLORE që lidh Tokën me qiellin, po theksoj: PIKËRISHT MBI BALLKAN.

Pra, dy shtylla qiellore, që përshkojnë qiellin dhe Tokën, janë dy polet qiellorë, DY BOSHTET QIELLORE që përshkojnë Trekëndëshin e Bermudeve dhe Ballkanin. Shkencat e mistikës, botimet për misteret, në shpjegimet dhe formulat për kuptimin e PORTËS SË PARAJSËS apo te KËRTHIZËS, sigurisht të ndihmojnë për të gjetur KËRTHIZËN E BOTËS, RRUGËN DREJT PAQES DHE LUMTURISË.

Deri këtu kemi disa referenca që na çojnë në një hipotezë mbresëlënëse për vendodhjen e qytetërimit të lashtë *paraardhës siç duket i qytetërimit tonë shqiptar dhe më tej*. Sigurisht që për të mbërritur aty duhet një rrugë e gjatë kërkimore. Dhe qëllimi i krijimit të shoqatës "Qënd-ra e studimeve pellazgjike", është pikërisht ky, një rrugëtim i gjatë, që duhet filluar dhe vazh- duar

me pjekuri, durim, tolerancë dhe më e rëndësishmja ... mirëkuptim. .  
Kush mund të jetë esenca e këtij shkrimi? Po citoj një *thënie të artë*: "...Kur takon njerëz, mendimet e të cilëve ndryshojnë nga tuajat, *mos* u ktheni shpinën atyre, të gjithë janë në kërkim të së vërtetës dhe ka shumë rrugë që të çojnë atje". (Abdul Baha "Përmbledhje" f. 39). Dhe prej këtej të ndërtojmë, le ta themi pa frikë, qëllimin tonë të ARTË se ne duhet të veprojmë jo për të fituar ndaj të tjerëve por të veprojmë për ti fituar ata, duke u marrë me GJËRAT QË NA BASHKOJNË dhe jo me ato që na ndajnë, ndryshe mund të rrëzohemi pa u ngritur mirë.

## 2. PËRFUNDIME

- "Misteret antike kanë të bëjnë me një numër dijesh të fshehta...që të jep aftësi të fuqishme, që gjenden të fjetura në mendjet e njerëzve".

## 3. STUDIME MBËSHTETËSE

1. "Pellazgët e pasardhësit e tyre" nga Eduard Shnajder, f.61.
2. J. Marrs "Kush e sundon botën" f.210.
3. "Tirana Observer" 5.4.2011 f.10-11
4. Në gazetën "Standart" 10.01.2011 f.16-17
5. Eduard Shnajder "Pellazgët dhe pasardhësit e tyre" f. 35
6. E.Kocaqi "Roli pellazgo- ilir në formimin e kombeve dhe gjuhëve europiane" f.75